



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilideno ME/Dana 21-10-2022			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetës Prilog	Vlera Vendos
02-11/01	1190		



KOMUNA E VITISË
OPŠTINA VITINA
MUNICIPALTY OF VITINA

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Viti

Në bazë të nenit 79 dhe 80 dhe 82 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, Rregullore QRK nr.05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nënpunësit Administrativ dhe Mbështetës , Komuna e Vitisë shpallë :

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Komuna e Vitisë
Departamenti/Drejtoria: Drejtoria për Administratë të Përgjithshme në Viti

1. Titulli i vendit të punës: 1 (një) pozitë Punëtor teknik-Elektricitist
Lloji i pozitës: Nëpunës Administrativ dhe Mbështetës
Koeficienti 5 (pesë)
Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e stafit Administrativ dhe Mbështetës;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës Puntor teknik:

- Mban rrjetën elektrike në gjendje të rregullt;
- Kryen përmisimet e instalimit elektrik, stabilimentëve elektrike dhe montimin e kablove elektrike për nevoja të objekteve Komunale.
- Bëne ndërrimin e prizave, ndërprersave, fytrat e poqave elektrik;
- Mban evidencën mbi ndërrimin e pjesëve të reja të vërtetuara nga nga ana e udhëheqësit të mirmbajtjes teknike;
- Shënon përshkrimin e punëve të kryera dhe objektin e tij;
- Kujdeset për mirembajtjen e klimave në të gjitha objektet komunale :
- Kujdeset për mirembajtjen e nxemjes në objektet komunale ,
 - Kujdeset për mirmbajtjen e gjeneratorit dhe furnizimin me derivate.
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të udhëheqësit të mirmbajtjes teknike.

Kualifikimi dhe përvoja:

- Të ketë të kryer shkollën e mesme.
- Të ketë së paku dy vite pervoj pune në fushen për të cilën kerkohet;
- Të ketë aktivitete dhe trajnime ;
- Të ketë shkashtësi për pune të pavarur dhe në ekip si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Dokumentet e kërkuara për të gjithë kandidatët-aplikantët:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (letërnjoftim) i fotokopjuar;
- Diploma e kualifikimit kopje e noterizuar;
- Dëshmitë e përvojës së punës kopje e vertetuar nga ATK dhe me trust pensional.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime (origjinal);

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

15 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 8 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 04.11.2022 deri 11.11.2022 (16:00).

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në Zyrën e Arhivës të Komunës së Vitisë, kati përdhësë në ndërtesën e administratës së Komunës së Vitisë si dhe mund të shkarkohet nga ueb-faja zyrtare e Komunës së Vitisë, <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkurset-njoftimet/> dhe <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Arhivës apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Vitisë, Rr. "Hasan Kabashi" pa.nr. Viti, Rezultatet shpallën në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkurset-njoftimet/>

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore


Hysen Ymeri